



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

VENDIM

Nr. 3 , datë 25.03.2025

PËR
MIRATIMIN E “RAPORTIT VJETOR TË
AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE PËR VITIN 2024”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 7, të nenit 52 pika 1, shkronja (l) dhe të nenit 53, pika 5, shkronja (ë) të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave” i ndryshuar, të nenit 8, pika 2, shkronja “d” të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 18 pika 2 të Rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014, si dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Raportit vjetor të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2024”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për paraqitjen e raportit vjetor pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave dhe Autoritetit Mbikëqyrës, sipas afateve të përcaktuara në ligjin nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar.





3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi dhe të raportit vjetor në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shqipe Malaj

Sekretare

Donald Duraj

Kryetar

